


Dok.	TIA-IMS-POL-005	Politika e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë	
Rish.	01		
Datë	01/07/2024		I Brendshem/I Jashtem

POLITIKA E SHËNDETIT DHE SIGURISË NË PUNË

Në zhvillimin dhe menaxhimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Tiranës, TIA ka ngritur dhe po zbaton e mirëmban Politikën e Shëndetit dhe Sigurisë në Punë (OHS). Sistemi i Menaxhimit OHS përshkruan synimin e Kompanisë për të garantuar vazhdimisht shëndetin dhe sigurinë e personelit të saj, si një pjesë jetike e funksionit të saj. Për këtë arsye, kompania zbaton dhe mirëmban një Sistem të Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në Punë (ISO 45001:2018), i cili vendos dhe monitoron qëllimet dhe objektivat sipas procedurave dhe standardeve të përcaktuara.

TIA zbaton një sistem menaxhimi brenda fushës së aktiviteteve të TIA-s dhe në përputhje me standardin e mësipërm.


Për më tepër, kompania angazhohet për:

- Të zbatuar standarde të shëndetit dhe sigurisë në punë sipas legjislacionit shqiptar.
- Të siguruar që pajisjet dhe procedurat operacionale janë të sigurta dhe nuk përbëjnë ndonjë rrezik për shëndetin dhe sigurinë e personelit.
- Të siguruar që janë marrë të gjitha masat e nevojshme në lidhje me trajtimin, ruajtjen dhe transportin e sigurt të mallrave dhe lëndëve të rrezikshme.
- Të ofruar informacione, buletine, trajnime dhe mbikëqyrje, të cilat janë thelbësore për Sigurimin e Shëndetit dhe Sigurisë.
- Të mbrojtur shëndetin dhe sigurinë e vizitorëve, furnitorëve dhe publikut brenda ambienteve të TIA-s.
- Të rishikuar politikën e saj, dhe kur është e nevojshme, të informojë të gjitha palët e përfshira, veçanërisht për sa i përket ndryshimeve të rëndësishme në rregulloret e TIA-s ose/dhe në legjislacionin shqiptar.
- Të siguruar që i gjithë personeli të jetë konsistent ndaj detyrimeve që rrjedhin nga standardet e shëndetit dhe sigurisë në punë.
- Të siguruar ndjekjen në mjedisin e punës të politikës së shëndetit dhe sigurisë në punë.
- Të mirëmbajtur një sistem të vazhdueshëm dhe përmirësues në lidhje me shëndetin dhe sigurinë në punë të punonjësve.


Direktivat që kanë të bëjnë me sigurinë dhe shëndetin e punonjësve përshkruhen në Manualin e Punonjësve dhe në proceset përkatëse të kompanisë.

Tirana International Airport, 1 Korrik 2024

Marsida Pallko
Administratore e TIA-s




Piervittorio Farabbi
Menaxher Përgjegjës i TIA-s dhe
Administrator / COO



Page 1 of 1